

Unë: BLERIM ISUFAJ (emri, mbiemri) deklaroj me bindje të plotë se këtë vlerësim e kam plotësuar vet dhe se përbajtja në të është e saktë.

Nënshkrimi: I. Hmij

Data: 02. 11. 2023

#### FORMULARI NUMËR 4

#### KONCEPT DOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Mbiemri:	ISUFAJ
Emri:	BLERIM

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

##### I. Analizën tuaj, si vijon:

- Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Prokurori i Shtetit ka kaluar nëpër fazat e ndryshme jo pak sfiduese dhe me impakt nga praktikat e ndryshme ndërkombëtare e ndryshime të shumta ligjore. Pas shumë viteve është arritur që të përbushet deri diku resurset njerëzore, është bërë progres në aspektet e planifikimit dhe përmirësimit të kushteve të punës.

Megjithatë duhet punë për arrijeten e standardeve të pranuara sidomos në trajtimin e rasteve komplekse që ne si prokurori të ngritim besimin e publikut.

Korniza kushtetuese dhe ligjore aktuale, mundëson që Prokurori i Shtetit të veprojë si organ i pavarur në punën e tij. Padyshim që ka nevojë për reforma në sistemin e drejtësisë dhe atë prokurorial në veçanti, por që qellimi duhet të jetë në ngritjen e

integritetit të sistemit prokurorial, fuqizim të sigurisë juridike për punën e prokurorëve dhe përmirësim të kushteve të punës.

Prokurori i Shtetit, si rezultat i ngritjes së vazhdueshme profesionale dhe të kapacitetave njerëzore, por edhe mbështetjes së fuqishme të partnerëve ndërkombe tarë, ka hyrë në një fazë të zhvillimit të qendrueshëm. Megjithatë sfidat nëpër të cilat aktualisht kalon ky institucion, nuk i kontribuojnë zhvillimit të mëtejmë të këtij institacioni. Është jetike që Prokurori i Shtetit të përcaktojë plane pune të mirë analizuara dhe të përmirësojë më tej proceset e punës. Të ngisë profesionalizmin e prokurorëve dhe rrisë llogaridhëni e integritetin.

- *Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë që keni aplikuar?*

Proceset e punës në Prokurorinë Speciale janë fuqizuar dukshëm në vitet e fundit. Kjo edhe si rezultat i ndryshimeve pozitive që kanë ndodhur me strukturimin e prokurorisë por edhe me qasjen proaktive ndaj sfidave të evidentuara.

Marrë në konsideratë se janë identifikuar dhe analizuar saktë problemet e kësaj prokurorie, kanë mundësuar që të përcaktohen politikat dhe strategjitë adekuate dhe që kanë dhënë rezultate të prekshme.

Sot prokurorët special janë të profilizuar dhe kjo ndikon edhe në rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të tyre. Janë të indeksuar të gjitha lëndët, e sidomos ato të kimeve të luftës ku pos indeksimit edhe janë caktuar ekipet e bashkëpunëtorëve dhe policëve që veprojnë nën udhëheqjen e prokurorit special. Nga viti në vit shënohet progres në trajtimin e lëndëve dhe vetëm në 3 mujorin e 3-të këtij viti janë zgjidhur për 30% më shumë lëndë se që janë pranuar. Është fuqizuar bashkëpunimi me institucionet e sundimit të ligjit e sidomos me policinë. Po ashtu janë krijuar raporte të mira bashkëpunimi me partnerët ndërkombe tar, ku në veçanti kanë përfituar prokurorët special përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave.

- *Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?*

Prokuroria Speciale përkundër të arriturave evidente, ballafaqohet edhe me sfida të shumta.

Në këtë drejtim, sfidë është edhe numri jo mjaftueshëm i prokurorëve dhe personelit tjetër mbështetës, sidomos në Departamentin për Krime të Luftës. Lëndët që trajtohen nga kjo prokurori janë të natyrës shumë komplekse dhe përfshijnë krimet më serioze, andaj edhe mbështetja e institucioneve të zbatimit të ligjit duhet të jetë më e fuqishme dhe më e strukturouar. Po ashtu, duhet të fuqizohet bashkëpunimi ndërkufitar dhe ai i karakterit regional e më gjerë për faktin se natyra e kimeve që ndiqen nga kjo prokurori i kalon kufinjtë shtetërorë të Kosovës.

Prokurorët dhe personeli administrativ duhet të vazhdojë të mbështetet me njohuri profesionale dhe praktikat e vendeve të zhvilluara.

Po ashtu sfidë është edhe zbatimi dhe përshtatja e prokurorisë me ndryshimet në Ligjin për PSRK-në.

- *A mendoni se strategjitet aktuale të sistemit adresojnë nevojat e Prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?*

Aktualisht, strategjia e PSRK-së është e përbushur dhe ka nevojë që të përditësohet dhe të plotësohet duke i adresuar qartë nevojat, vështirësitë por edhe zgjidhjet e duhura për tekalimin e tyre. Sidomos në kohën kur kemi një ligj të ri për PSRK-në, strategjia e re është ndër prioritet e para.

Jo më pak i rëndësishëm është edhe zhvillimi i programeve adekuate të trajnimit në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtarë. Po ashtu proceset e punës përritjen e efikasitetit të rrjedhës së lëndës dhe në përgjithësi për punën e kësaj prokurorie janë të rëndësishme të adresohen nga të gjithë mekanizmat udhëheqës të sistemit prokurorial.

## **II. Vizioni juaj në përmirësimin e punës operative në Prokurorinë që keni aplikuar?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

- *Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?*

Përmes qasjes proaktive në planifikim dhe zbatim të mandatit ligjor, gjithëpërfshirjes, komunikimit dhe bashkëpunimit, Prokuroria Speciale të veprojë me integritet të lartë, profesionalizëm, pavarësi të plotë, transparente dhe llogaridhënëse në mbrojtje të interesit shtetëror, të dëmtuarve dhe viktimave të krimít.

- *Cilat janë objektivat tuaja kryesore?*

Përcaktimi i objektivave të mia kryesore do të ketë në fokus administrimin efikas dhe të shpejtë të prokurorisë si dhe hetimin dhe ndjekjen e suksesshme të kryesve të vperave penale, duke krijuar kushte pune adekuate dhe mundësi për zhvillim profesional e fuqizim të llogaridhëniec së prokurorëve dhe personelit mbështetës.

Planifikimi dhe organizimi i punës së Prokurorisë Speciale me qellim të përbushjes së vizionit tim dhe mandatit ligjor të kësaj prokurorie, mbështetet në objektivat në vijim:

- **Fuqizimi i mëtejshmë i administrimit të Prokurorisë Speciale dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve**

Për arritjen e kësaj objekteve nevojitet hartim i dokumenteve në baza periodike si dhe politika e dokumente afatgjata.

Ndër proceset që duhet të rishikohet dhe të krijohet një model i mbështetur në nevojat e prokurorisë dhe bazuar në praktikat më të mira është sistemi efektiv i menaxhimit të lëndëve brenda prokurorisë, e i cili përmblidhet në 4 elemente kryesore:

**1. Udhëheqje efektive** - do ti motivojë dhe udhëheqë tjerët përmes artikulimit të një vizioni se si do ta udhëheqë përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve në Prokurorinë Speciale, se si do të përfitojë secili nga personeli me këto ndryshime, po ashtu duke dhënë përkushtimin maksimal timin dhe duke ndarë me bashkëpunëtorët progresin dhe duke shpërblyer ata në arritjen e objektivave.

**2. Zhvillimi i lëndëve brenda afateve të arsyeshme kohore** - Në këtë drejtim, duhet të zhvillohen udhëzime të qarta në formë të listave kontrolluese me veprimet që duhet ndërmarrë nga momenti i pranimit të lëndëve e deri në përfundim të tyre. Pa ndikuar në afatin ligjor të hetimeve, qasja përmes një plani të strukturuar në secilin rast, ndihmon që lënda të kryhet brenda një afati të arsyeshëm kohor (*jo me çdo kusht të priten afatet ligjore për përfundim të lëndëve*).

**3. Ushtimi i kontrollit të hershëm dhe të vazhdueshëm të ecurisë së lëndëve** - Vlerësojë se është përgjegjësi e prokurorit të lëndës dhe e Kryeprokurorit që ta trajtojë rrjedhën e lëndës nga momenti i pranimit të saj duke u siguruar që nuk ka pengesa të paarsyeshme në progresin procedural deri në përfundim të lëndës.

Andaj kontrolli i hershëm dhe i vazhdueshëm me progresin e lëndës është jetik për përmbyllje të lëndës brenda afateve të arsyeshme. Në këtë drejtim do t'i ofrojë mbështetje secilit prokuror.

**4. Sistem efikas elektronik për menaxhimin e lëndëve** - Sistemi elektronik përvetësuar ndarjet objektive dhe të shpejtë të lëndëve mundëson edhe unifikim të formave të shkresave, si dhe mundëson që secili prokuror dhe kryeprokurori të ketë një pasqyrë reale për rrjedhën e lëndës.

Pa dashur të komentojë sistemin elektronik të menaxhimit të lëndëve që ne e kemi, vlerësojë se është domosdoshmëri që të krijojmë një sistem elektronik plotësisht funksional, miqësor në përdorim, me mundësi të gjenerimit të të dhënavë të shumëlojshme, të cilat mundësojnë një menaxhim adekuat të lëndëve. Këtu dua të shtojë se ndërlidhja e sistemeve elektronike ndihmon jashtëzakonisht shumë në efikasitetin e trajtimit të lëndëve.

Krahas këtij plani, do të përgatiten edhe plane dhe dokumente tjera të rëndësishme, të cilat do të ndikojnë në efikasitetin e punës së prokurorisë, si në vijim:

- Politika realiste të prokurorisë dhe propozimet për përmirësim të sistemit adekuat elektonik.
- Hartimi i planit vjetor të punës së PSRK-së;
- Përgatitja dhe dergimi i shpejtë në prokurori i dokumentacionit të nevojshëm policor, mjeko-ligjor, etj.
- Formimi i ekipeve të përbashkëta të hetimit për raste komplekse.
- Vazhdimi i shënjestrimit të lëndëve komplekse.
- Marrja e shpejtë e informacionit për të kaluarën e mëparshme kriminale.
- Ekzaminimi dhe verifikimi efektiv i rasteve të hershme nga prokurori.
- Caktimi në kohë i mbrojtësit për të akuzuarin, procedura gjyqësore që sigurojnë pjesëmarrjen e shpejtë të mbrojtësit për të akuzuarin.
- Përcaktimi i pistave të veçanta për përpunimin e lëndëve në varësi të kompleksitetit të tyre.
- Praktikat e planifikimit të rasteve që lehtësojnë zgjidhjen e shpejtë të rasteve të thjeshta (p.sh. zgjidhja alternative e rasteve).
- Përgatitjen e raporteve të rregullta dhe sipas nevojës për punën e PSRK-së;
- Të rritet niveli i përgjegjësive i të gjithë të punësuarve në PSRK;
- Të ketë numër adekuat të prokurorëve dhe personelit mbështetës në përputhje me ngarkesën e punës;
- Zhvillimi i një “kulture pune” që në fokus ka eliminimin e vonesave në trajtimin e lëndëve.

**- Rritje e llogaridhënieve, profesionalizmit dhe transparencës**

Ndarja e prokurorëve në departamente, dhe indeksimi i plotë i lëndëve përfshirë dhe monitorimin sistematik të lëndëve të vjetra ka ndikuar që të ngritet llogaridhënya brenda Prokurorisë Speciale. Mekanizmat aktual të monitorimit të brendshëm do të rishikohen me qellim të avancimit të mëtejmë të llogaridhënieve në funksion të përmirësimit të cilësisë së punës.

Në anën tjetër do të punojmë ngshtë me prokurorë dhe personelin administrativ me qellim të identifikimit të nevojave të tyre për ngritje të komptencës profesionale dhe përfshirje të tyre në programe shkëmbimi të përvojave trajnime të ndryshme.

Po ashtu do të promovojë një kulturë të komunikimit të tillë që mundëson këshillim dhe udhëzime në çdo kohë për secilin prokuror qoftë nga ana ime apo krijimit të mundësive për këshillëdhënie dhe ekspertiza vendore dhe ndërkombëtare.

Në pajtim me ligjin dhe standarde përcaktura do të sigurojë kushte për komunikim të rezultateve të punës dhe dhënie të informatave të nevojshme për të interesuarit me qellim të rritjes së transparencës dhe besimit të publikut në punën e Prokurorisë Speciale.

- **Fuqizim i bashkëpunimit me institucionet e zbatimit të ligjit vendore dhe ndërkuftare.**

Brenda kornizave ligjore dhe duke ndjekur praktikat më të mira do të avancojë tutje bashkëpunimin me institucionet e sundimit të ligjit qoftë lidhur me menaxhimin e prokurorisë apo krijimin e lehtësive që prokurorët dhe stafi të kenë bashkëpunimin e nevojshëm për çështje operative.

Po ashtu, do të jem i gatshëm ta ruaj dhe fuqizojë mëtej bashkëpunimin me shtetet ndërkuftare dhe organizatat e karakterit regjional e ndërkombëtar.

#### *4. Cilat janë vështirësítë që i prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?*

Jam i vetëdijshëm që objektivat e lartpërmendura janë sfiduese dhe kërkojnë angazhim të madh jo vetëm timin por edhe të kolegëve në PSRK.

Për zbatimin e mandatit ligjor dhe funksioneve të saj, PSRK, do të përballet me këto sfida:

- Zbatimi i ndryshimeve legjislativë;
- Mbështetja nga ana e Këshillit Prokurorial dhe institucioneve tjera;
- Plotësimi i pozitave të nevojshme sipas nevojave për prokurorë dhe personel administrativ;
- Adoptimi i Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve - SMIL sipas nevojave dhe specifikave të PSRK-së;
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e prokurorëve dhe personelit administrativ sipas nevojave specifike të tyre;
- Ngritja e bashkëpunimit me institucione të zbatimit të ligjit;
- Identifikimi i problemeve dhe tejkalimi i tyre, të cilat paraqiten në procesin e hetimeve me institucionet respektive;
- Rritja e nivelit dhe cilësisë së ekspertizave;
- Bashkëpunimi me institucionet vendore që mund të ofrojnë ekspertizë përfusha të ndryshme;
- Rritja e numrit të rasteve dhe vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;

#### *5. Si do t'i tejkalonit ato?*

Këto objektiva kërkojnë përkushtim dhe përvojë, e cila deri më tanë nuk ka munguar. Për më tepër edhe vet përvoja ime e deritashme, më jepin besim se me një punë ekipore do të arrijmë që të përbushimin vizionin e përcaktuar përfshira zbatim të mandatit të Prokurorisë Speciale.

### **III. Vizioni juaj për të avancuar administratën në Prokurorinë që keni aplikuar;**

Ju lutem renditni hapat konkret që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

#### *1. Cilat janë metodat dhe mënyrat tuaja për avancimin e stafit administrativ?*

Stafi administrativ në PSRK, viteve të fundit është rritur në numër dhe është punuar vazhdimesht për avancimin e kapaciteteve të tyre profesionale. Duke e konsideruar një aset me vlerë për punën e suksesshme të prokurorëve, stafi do të trajnohet, udhëzohet dhe këshillohet të respektojë standarde të larta të performancës dhe etikës. Do të punoj ngusht me KPK-në, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Akademinë e Drejtësisë dhe partnerë të ndryshëm për të zhvilluar programe adekuate trajnimi për stafin, ndërsa prokurorëve do t'u jepen udhëzime të qarta se si duhet përfshirë stafi me të cilët punojnë drejtpërdrejtë në procese si planifikimi dhe zgjidhja e lëndëve. Stafi i cili është pjesë e ekipit për organizim dhe funksionim të proceseve të punës me lëndë do të trajnohet dhe udhëzohet në respektim të standardeve të cilat garantojnë besim më të madh të palëve në procedurë dhe publikut në përgjithësi. Motivimi i stafit, përfshirë trajtimin e duhur financiar do të jetë një nga priorititetet e mia përderisa vlerësimi i performancës dhe zhvillimi në karrierë do të bëhen vetëm bazuar në meritë.

#### *2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin administrativ?*

Ndarja e punëve për stafin sadministrativ do të bëhet duke marrë për bazë përgjegjësitë e tyre të punës, kërkesat e prokurorëve për të menaxhuar lëndët si dhe nevojat e organizimit të punëve në RSRK. Në këtë drejtim do të respektohen standarde të njoitura për një shpërndarje të barabartë të punës pa bërë kompromis me nevojat prioritare dhe kërkesat ligjore lidhur me afatet e zhvillimit të punëve të prokurorëve rreth lëndëve si dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara me planin e punëve, politikat dhe strategjitet e PSRK-së. Do të punoj që përmes punës ekipoje të zhvillojmë aktivitete në funksion të avancimit të PSRK-së ku përgjegjësitë për realizimin e aktiviteteve shtesë të ndahan në mënyrë vullnetare dhe që ndërmarrja e tyre të jetë e përbashkët. Nuk do të mungojnë udhëzimet për prokurorë si dhe hartimi i protokoleve për efikasitet në trajtimin e kërkesave nga ana e stafit administrativ bazuar në parimin e shërbimit efikas, etik, të përgjegjshëm dhe profesional.

#### *3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhiënien dhe profesionalizmin e stafit administrativ?*

Zbatimi i detyrateve dhe përgjegjësive të punës me profesionalizëm dhe etikë të lartë nga ana e stafit administrativ do të jenë në fokus të vazhdueshëm për mua si

kryeprokuror i PSRK-së. Avancimi i kulturës së raportimit të punëve dhe vlerësimi i kualitetit të tyre nga secili epror do të jetë në barrë të përgjegjësive të mia mbikëqyrëse. Përveç raporteve të rregullta do të kërkohen edhe raporte specifike për punë dhe procese të cilat synoj të arrijnë pasqyrim të sakt të rrjedhave për zgjidhje të lëndëve dhe performancë të PSRK-së.

Për më tepër do të krijohen kanale funksionale të komunikimit përmes teknologjisë informative, takimeve të rregullta dhe njoftimeve të shkurta e të shpejta me shkrim. Do të punohet që të gjitha profilet e stafit të marrin trajnime të nevojshme, të kenë kushtet e duhura për punë si dhe të avancojnë shkathtësitë e tyre vazhdimisht.

#### **IV. Hapat që do të ndërmerrni në përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënieς në Prokurorinë që keni aplikuar dhe besimin e publikut?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

- *Përvoja e juaj e deri tanishme?*

Bazuar në përvojën time si kryesues i KPK-së dhe kryeprokuror i PSRK-së, integriteti dhe llogaridhënia ishin dy nga vlerat kryesore të sistemit prokurorial. Në këtë drejtim kam qenë direkt i përfshirë në hartimin dhe zbatimin e planeve strategjike, planeve të punës, politikave dhe vendimeve të shumta. Kjo përvojë më ka ndihmuar që në mandatin e dytë si kryeprokuror i PSRK-së të përcaktojë qartë hapat që do të ndërmarr në përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënieς në PSRK.

- *Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?*

Fillimi isht do të qëndroj i informuar për zhvillimet në jetën shoqërore, institucionale dhe jo vetëm. Do të jem transparent para, prokurorëve dhe stafit të PSRK-së, para palëve pjesë e procedurës që zhvillon PSRK si dhe para publikut (përmes mediave dhe forumeve të ndryshme), gjithmonë duke respektuar vlerat kryesore të mbrojtura me ligj.

Po ashtu do të vlerësoj rezultatet e arritura nga prokurorët dhe motivoj ata që arrijnë suksesë në punë, por edhe do t'i kritikoj me qëllim përmirësimi, ata që bëjnë gabime

ose kanë mangësi, me një fjale do të behem pjesë e suksesit, arritjeve pozitive, por edhe marr përgjegjësinë për këto të meta dhe mangësi.

Me qëllim të ngritjes së besueshmërisë në punën e PSRK-së do të mbështes dhe inkurajoj ngritjen profesionale sipas nevojave të prokurorëve dhe stafit duke u bazuar në kompetencat që është e nevojshme të zhvillohen tutje. Për më tepër planifikoj të marr vendime të këshilluara mirë dhe pas një hulumtimi të mundësive adekuate e burimeve të besueshme. Në të njëjtën kohë do të promovojoj tek prokurorët një vendimmarrje bazuar në ligj, prova dhe fakte të elaboruara mirë, por edhe në llogaritje të mirë të përparësive dhe pasojave të vendimeve.

Në fund për qëllime të punës së suksesshme të PSRK-së do të inkurajoj bashkëpunimin dhe punën ekipore përmes formimit të ekipeve për punë, projekte dhe ofrim të informatave, udhëzimeve dhe resurseve për arritje të rezultateve pozitive.

Edhe pse sfiduese, do të jetë prioritet që transparenca e punës së zhvilluar sipas hapave të sipërtheksuar të ketë një baraspeshë me respektimin e konfidencialitetit gjithnjë duke respektuar ligjin dhe standardet e ndërtuara në këtë fushë.

- *Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?*

Ndër synimet kryesore për mua si kryeprokuror i PSRK-së është që puna e kësaj prokurorie të jetë sa më cilësore. Këto synime do të përblidhen në një dokument për sigurimin e cilësisë. Ky dokument do të përcaktojë thjesht qëllimet në arritjen e cilësisë, respektivisht do të caktojë objektiva dhe politika cilësore, procedura të qarta, procese për analizimin dhe kontrollin e cilësisë, udhëzime për pune si dhe kontroll të kualitetit të punës (analizimi i të dhënave të gjeneruara nga raportet e SMIL, databazat, etj).

- *Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhëni e përgjithshme në Prokurorinë tuaj?*

Llogaridhënia në PSRK do të thotë që të gjithë prokurorët dhe stafi marrin përgjegjësi për performancën e tyre, përfshirë rezultatet pozitive dhe negative.

Ngritjen e llogaridhëniec në kuadër të PSRK-së do ta bëjë përveç tjerash edhe duke vendosur pritshmëri të qarta për prokurorët dhe stafin, duke i bërë të gjithë përgjegjës për planin e punëve për zgjidhje të lëndëve, caktimit të detyrave konkrete për prokurorët dhe stafin, ndërtimin e një sistemi të pranimit të të metave dhe eleminimit të tyre si dhe motivimi dhe qortimi kurdo që duhet dhe meritohet.

Llogaridhënia do të bëhet vlera kryesore e PSRK-së ku përveç tjerash do të udhëheqë gjithmonë përmes shembujve të nisur nga vetja, do të caktoj prioritete të qarta dhe konkrete për punën e prokurorëve dhe stafit si dhe do të mbjellë besueshmëri dhe do të kërkoj besim nga të gjithë.

Konceptdokumenti nuk duhet të përbajë më shumë se 10 faqe me shkrim e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësirë njëshe.

Deklaroj se përbajtjen e këtij Konceptdokumenti e kam përgatitur vet, dhe jam në dijeni se Konceprdokumenti i Kryeprokurorit të emëruar do të publikohet në ueb faqe.

Nënshkrimi: 

Datë: 02.11.2023

## FORMULARI NR.5

### Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit

Emri dhe mbiemri i kandidatit: \_\_\_\_\_

ANËTARI	KONCEPT DOKUMENTI	INTEGRITETI	AFTESITE MENAXHERIALE DHE UDHEHEQESE	NJOHURITE TEKNOLOGJIKE DHE PERVOJA E NEVOJSHME PER POZITEN
A				
B				
C				
D				
E				